



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT-ODBOR ZA USLOVNI OTPUST-CONDITIONAL RELEASE PANEL

PLK. D. nr. 48/24

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT, i përbërë nga Valdete Daka, kryesuese e Panelit, Burim Ademi dhe Argjira Asllani, anëtarë të panelit, me pjesëmarrjen e Mersime Mehmeti, u.d. koordinatore e panelit, duke vendosur përkitazi me kërkesën e datës 25.01.2024, për lirim me kusht, të parashtruar nga F. H., për shkak të veprave penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par. 3 lidhur me par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 10 muaj, me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr.348/21, i datës 16.03.2023, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin PA1.nr.707/2023, i datës 26.06.2023, në pajtim me nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06-L-074), nenin 116, 117, 118 dhe 119 të Ligjit Nr. 08/ L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenet 9, 10, 11, 20 par. 1 dhe par. 2 pika 2.1 dhe neni 23, 25 dhe 26 të Rregullores Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht, në seancën e mbajtur me datë 12.02.2024, në selinë e KGJK-së në Prishtinë, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET kërkesa për lirim me kusht për të dënuarin F. H. nga i ati I. dhe e ëma F., e gjinisë U., i lindur me datë ..., në M., me vendbanim në Gj., rr. "...", nr. ., L., dhe në M., F., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. F. H. do të lirohet me dt. 16.02.2024, dhe do të jetë nën mbikëqyrje të Shërbimit Sprovues të Kosovës deri me dt. 01.07.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Mitrovicë, P.nr.348/21, i datës 16.03.2023, i vërtetuar nga Gjykata e Apelit me aktgjykimin PA1.nr.707/2023, i datës 26.06.2023, F. H. është shpall fajtor për shkak të veprave penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par. 3 lidhur me par. 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 të KPRK-së, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 10 muaj.

Në seancën e mbajtur me datë 12.02.2024, Paneli me rastin e shqyrtimit të dosjes së të dënuarit, ka shqyrtuar raportin përmbledhës të përpiluar nga ekipi profesionist i Shërbimit Korrektues të Kosovës, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 par. 6 të Ligjit Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe nenin 11 të Rregullores Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht.

Pas vlerësimit të të gjitha të dhënave të paraqitura në shkresat e cekura më lartë, Paneli ka gjetur se:

Në raportin ligjor për të dënuarin vërtetohet se të dënuarit, data e përfundimit të dënimit i është caktuar më 01.07.2024 dhe nga llogaritja e dënimit rezulton se i dënuari deri më tani i ka mbajtur 5 muaj, 10 ditë, ndërsa i kanë mbetur edhe 4 muaj, 20 ditë, të cilat do të mbikëqyren dhe kontrollohen nga Shërbimi Sprovues i Kosovës.

Në raportet e tjera të përpiluara nga ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese, rezulton se i dënuari gjatë mbajtjes së dënimit ka treguar sjellje të mirë dhe i angazhuar në punë. Lidhur me procesin e risocializimit konsiderohet se deri më tani mbajtja e dënimit ka pasur efekt pozitiv dhe se procesi i risocializimit është arritur, duke qenë se i dënuari tani është i gatshëm që të riintegrohet në familje dhe shoqëri.

Paneli vlerëson se tani është arritur qëllimin e dënimit të paraparë sipas nenit 5 dhe 6 të LESP-së lidhur me nenin 38 të KPRK-së, duke marrë parasysh shkallën e risocializimit të arritur për faktin se i dënuari ka treguar sjellje të mira, përkatësisht nuk ka të dhëna për shkelje disiplinore. Në të dhënat për realizimin e programit të trajtimit të dënuarit, rezulton se i dënuari është i angazhuar në punë dhe se efekti i burgosjes tek i dënuari ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e tij, me ç'rast rrezikshmëria për të ardhmen konstatohet e ulët. Po ashtu, gjatë shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht, Paneli ka vlerësuar edhe premtimin e dhënë zyrtarit të Shërbimit Sprovues të Kosovës se do të bashkëpunojë me këtë shërbim deri në përfundimin e mbikëqyrjes së lirimit me kusht dhe se me një mbikëqyrje efektive i dënuari me lehtësi do të ri-integrohet në familje dhe shoqëri në pajtim me ligjin, andaj duke marrë parasysh edhe kohën e mbetur në përpjesëtim me kohën e mbajtur të dënimit ngase ky person ka mbajtur më shumë se 1/2 e dënimit që nga data 01.02.2024, Paneli konstaton se mbajtja e dënimit ka arritur qëllimin e dënimit.

Paneli vendosi që ta lirojë me kusht personin e dënuar F. H., ai do të lirohet me kusht me dt. 16.02.2024 (e premtë ora 16:00), nën kushtet e mëposhtme:

Brenda pesë (5) ditësh nga data e lirimit nga burgu të lajmërohet në Drejtorinë Rajonale të Policisë së Kosovës, përkatësisht të Shërbimit Sprovues:

1. të raportojë rregullisht në Shërbimin Sprovues deri me datën 01.07.2024;
2. në rast të ndërrimit të vendbanimit ta njoftoj Policinë dhe Shërbimin Sprovues;
3. të mos tentojë që të udhëtojë jashtë shtetit, pa miratimin e Panelit për Lirim me Kusht;
4. të jetë me i kujdesshëm me sjelljet e tij në të ardhmen.

Udhëzim për Qendrën Korrektuese:

Qendra Korrektuese ku personi i dënuar është duke mbajtur dënimin duhet të ndër marr veprimet si në vijim:

- I.** kompletton shtojcën 2 të rregullores – Komunikimi i lirimit me kusht gjykatës kompetente;
- II.** kompletton shtojcën 3 të rregullores – Komunikimi i lirimit me kusht Policisë së Kosovës;
- III.** kompletton shtojcën 4 të rregullores – Komunikimi i lirimit me kusht Shërbimit Sprovues;
- IV.** i shpjegon personit të dënuar plotësisht kushtet e lirimit, përkatësisht obligimet ligjore mbi zbatimin e vendimit, kushtet mbi raportimin dhe pasojat e veprave të tjera.

Udhëzim për Drejtorinë Regjionale të Shërbimit Sprovues:

Drejtoria Regjionale e Shërbimit Sprovues duhet të ndërmarr veprimet si në vijim:

- I. Drejtoria përkatëse regjionale e Shërbimit Sprovues duhet që të njoftoj Panelin me raport për fillimin e mbikëqyrjes në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë punë nga data e lirimit të personit të dënuar, si dhe të e mbaje të informuar panelin me raporte periodike deri në datën e përfundimit të dënimit.

- II. Zyrtari Sprovues udhëzohet që të fokusohet mbi orientimin e të liruarit me kusht në kuptim të respektimit të kushteve të caktuara sipas aktvendimit të Panelit. Duke u bazuar në datën e përfundimit të dënimit për të dënuarin, ai do lirohej me datë 01.07.2024. Rekomandohet që i liruari të mban me vete aktvendimin mbi lirimin me kusht gjatë tërë kohës deri në skadimin e lirimit të tij me kusht, që është caktuar me datë 01.07.2024.

Personi i cili është liruuar me kusht është i njoftuar me faktin se:

- Lirimi me kusht mund të revokohet, dhe në disa raste duhet të revokohet, nëse i dënuari, gjatë lirimit me kusht kryen një apo me shumë vepra penale, neni 91 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës – Kodi nr. 06/L-074;
- I liruari me kusht është i obliguar që të njoftoj Policinë dhe Shërbimin Sprovues brenda pesë (5) ditëve të lirimit, për vendqëndrimin e përkohshëm të tij apo saj gjatë periudhës së lirimit me kusht;
- Personi i liruuar me kusht është i obliguar që të raportoj në Shërbimin Sprovues gjatë periudhës së lirimit me kusht;
- Nëse i liruari me kusht e ndërron vendbanimin, është i obliguar që të njoftoj Policinë dhe Shërbimin Sprovues;
- Nëse dështon të informoj apo raportoj siç u cek më lartë, Paneli mund t'a revokoj vendimin për lirim me kusht, neni 119 paragrafi 4 i Ligjit nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale lidhur me nenin 27 të Rregullores Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht.

Nga sa u tha si më lartë, në bazë të nenit 20 par. 2 pika 2.1 të Rregullores Nr. 12/2023, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT PLK. D. nr. 48/24, dt. 12.02.2024

U.d. Koordinatore e Panelit

Mersime Mehmeti

Kryesuese e Panelit

Valdete Daka

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.